

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

PROGRAMI
I KURSIT TË UNIFIKUAR
“MANIKYR PEDIKYR”

Kodi: PK-AA-3-22

Miratoi:

MINISTRI

.....

Tiranë, 2022

PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR

“Manikyr pedikyr”

(PK-AA-3-22)

I. Profili Profesional i punonjësit të shërbimeve manikyr pedikyr

a) Karakteristikat e punonjësit të shërbimeve manikyr pedikyr

Punonjësi i shërbimeve të manikyr pedikyrit është i aftë të kryejë *detyra* profesionale si i punësuar në qendra estetike apo sallone bukurie apo si i vetpunësuar për të ofruar shërbimet që kanë të bëjnë me trajtimin estetik të duarve dhe këmbëve të klientëve.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, punonjësit të shërbimeve të manikyr pedikyrit i duhet që të zotërojë *njohuri* profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë, si dhe *shprehje* profesionale që lidhen me veprimtarinë profesionale të manikyr pedikyrit.

Suksesi i punonjësit të shërbimeve të manikyr pedikyrit është i lidhur ngushtë dhe me *sjellje* (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathtësia, qetësia, kujdesi, përqendrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, korrektësia, disiplina etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e punonjësit të shërbimeve manikyr pedikyr

Profesioni i punonjësit të shërbimeve të manikyr pedikyrit është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për trajtimin estetik të duarve e këmbëve të klientit. Ai mund të punësohet ose vetpunësohet në sallone bukurie, qendra estetike, parukeri dhe biznese apo institucione të tjera që e ofrojnë ose e kërkojnë këtë shërbim.

Një individ mund të ushtrojë veprimtarinë e punonjësit të shërbimeve të manikyr pedikyrit fillimisht si ndihmës punonjës i shërbimeve të manikyr pedikyrit. Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë mund të përparojë profesionalisht në nivelin e punonjësit të kualifikuara të shërbimeve të manikyr pedikyrit. Më pas, nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale apo trajnimit nëpërmjet punës, një punonjës i shërbimeve të manikyr pedikyrit mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse, duke ngritur shkallët e karrierës si menaxher i një biznesi që ofron këto shërbime.

Për të zhvilluar aktivitet privat në sektorin e manikyr pedikyrit duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në njësinë “Kozmetologë dhe profesione që lidhen me të”, me kod 5142, referuar Listës Kombëtare të Profesioneve.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit për manikyr pedikyr.

Në përfundim të Kursit për manikyr pedikyr, kursantët do të jenë të aftë të:

- Kryejnë organizimin e vogël të punës në qendrën/sallonin e manikyr pedikyrit.
- Përdorin dhe interpretojnë dokumentacionin e manikyr pedikyrit.
- Përzgjedhin dhe përdorin mjetet, pajisjet dhe materialet e duhura të punës.
- Mirëmbajnë mjetet, materialet, pajisjet dhe mjedisin e punës.
- Kryejnë trajtimet e duarve.
- Kryejnë trajtimet e këmbëve.

- Kryejnë masazhime të duarve.
- Kryejnë masazhime të këmbëve.
- Kryejnë pastimin e kutikulave me pinceta.
- Kryejnë zgjatimin e thoit.
- Kryejnë ngjitjen e tipsave.
- Realizojnë dizeno të ndryshme dekorative.
- Kryejnë aplikimim e xhelit e akrilikut.
- Kryejnë pastrimin e thembrave me brisk.
- Kryejnë limimin e këmbëve.
- Kryejnë trajtimin me parafinë të duarve dhe të këmbëve.
- Kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike për shërbimet e manikyr pedikyrit.
- Këshillojnë klientët për mirëmbajtjen e duarve e këmbëve.
- Zbatojnë rregullat dhe kërkesat e trajtimeve estetike të duarve dhe të këmbëve.
- Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik, higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit në mjediset e punës.
- Komunikojnë me etikë profesionale.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin për manikyr pedikyr.

Pjesmarrësit në kursin për manikyr pedikyr duhet të jenë mbi 16 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e detyruar.

IV. Kohëzgjatja e Kursit për manikyr pedikyr.

300 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit për manikyr pedikyr.

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet e të Nxënit
1	Hyrje në shërbimet e manikyr pedikyrit.	MK-32-230-20	30 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë në shërbimet e manikyr pedikyrit. 2. Kursanti përshkruan mjedisin, mjetet dhe materialet e punës në shërbimet e manikyr pedikyrit. 3. Kursanti përshkruan rregullat e etikës, të higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit 4. Kursanti përshkruan anatominë dhe fiziologjinë e lëkurës dhe thoit.
2	Trajtimi dhe masazhimi i duarve.	MK-32-231-22	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e trajtimeve dhe masazhimeve të duarve. 2. Kursanti trajton duart. 3. Kursanti kryen masazhin relaksues të duarve. 4. Kursanti këshillon klientin për mirëmbajtjen e duarve.

3	Ndërtimi i thoit me manikyr xhel, xhel dhe akrilik.	MK-32-232-22	110 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e ndërtimeve të thoit me xhel, manikyr xhel dhe akrilik. 2. Kursanti ndërton thoin me manikyr xhel. 3. Kursanti ndërton thoin me xhel. 4. Kursanti ndërton thoin me akrilik.
4	Trajtimi estetik i këmbëve.	MK-32-233-20	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan anatominë dhe fiziologjinë e lëkurës së këmbëve, si dhe semundjet e thoit. 2. Kursanti kryen procedurën e pedikyrit. 3. Kursanti kryen masazhin relaksues të këmbëve. 4. Kursanti këshillon klientin për mirëmbajtjen e këmbëve.
5	Zgjatimi dhe riparimi i thonjve	MK-32-234-20	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti kryen zgjatimin e thoit me tipsa. 2. Kursanti kryen zgjatimim e thoit me kartinë. 3. Kursanti ngjit thoin me fibër/copë/mëndafsh, për riparimin e tij.

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet e të Nxënit që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për manikyr pedikyrit.

1. Moduli “Hyrje në shërbimet e manikyr pedikyrit

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË SHËRBIMET E MANIKYR PEDIKYRIT	MK-32-230-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e punonjësit në shërbimet e manikyr pedikyrit, me mjedisin dhe mjetet e punës së këtij punonjësi, me rregullat e etikës, të higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit, si dhe me veçoritë anatomike dhe fiziologjike të lëkurës dhe thoit së njeriut.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç.	
Rezultatet e të Nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përshkruan veçoritë në shërbimet e manikyr pedikyrit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të argumentojë historikun, qëllimin dhe rëndësinë e shërbimeve të manikyr pedikyrit për individin; - të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore të punës në shërbimet e manikyr pedikyrit. - të përshkruajë mjediset, mënyrën e organizimit dhe kushtet e punës në shërbimet e manikyr pedikyrit. - të përshkruajë proceset bazë të veprimtarisë në shërbimet e manikyr pedikyrit. - të tregojë organizimin e punës në një qendër ku ofrohen shërbimet e manikyr pedikyrit. - të tregojë si organizohet grafiku i takimeve për shërbimet e manikyr pedikyrit në një qendër estetike. - të përshkruajë ndërtimin dhe mënyrën e plotësimit të bazës së të dhënave të klientit; - të përshkruajë kërkesat profesionale që nevojiten në shërbimet e manikyr pedikyrit. - të tregojë mundësitë e punësimit dhe të karrierës profesionale të punonjësit në shërbimet e manikyr pedikyrit. - të përshkruajë kuadrin ligjor të veprimtarisë në shërbimet e manikyr pedikyrit; - të përshkruajë kërkesat për liçensim për ushtrimin e	

veprimtarisë në shërbimet e manikyr pedikyrit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Pyetje përgjigje me shkrim.

RN 2 Kursanti përshkruan mjedisin, mjetet dhe materialet e punës në shërbimet e manikyr pedikyrit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë mjedisin e një qendre apo salloni te manikyr pedikyrit;
- të organizojë dhe mirëmbajë mjedisin e punës në sallonin e manikyr pedikyrit.
- të përshkruajë dhe të dallojë veglat, mjetet dhe pajisjet e punës në shërbimet e manikyr pedikyrit;
- të tregojë përdorimet e veglave, mjeteve dhe pajisjeve në shërbimet e manikyr pedikyrit;
- të mirëmbajë veglat, mjetet dhe pajisjet e punës gjatë shërbimeve të manikyr pedikyrit;
- të dallojë materialet e punës në veprimtarinë e shërbimeve të manikyr pedikyrit;
- të tregojë përdorimet e materialeve të punës gjatë shërbimeve të manikyr pedikyrit;
- të interpretojë etiketat dhe udhëzimet e prodhuesit që ofrojnë materialet e punës për shërbimet e manikyr pedikyrit.
- të sistemojë dhe mirëmbajë materialet e punës së manikyr pedikyrit.
- të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti përshkruan rregullat e etikës, të higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë veçoritë e tipeve të ndryshme të klientëve;
- të dallojë tipet e ndryshme të klientëve;
- të përshkruajë rregullat e komunikimit me etikë profesionale me klientët, eprorët, kolegët etj.;
- të përshkruajë dhe të zbatojë rregullat e higjienës personale;
- të përshkruajë dhe të zbatojë rregullat e higjienës personale, të klientit, të mjedisit dhe mjeteve të punës;
- të përshkruajë dhe të zbatojë rregullat e sigurisë së klientit dhe të mjedisit të punës;
- të përshkruajë dhe të zbatojë rregullat e mbrojtjes nga zjarri, nga rryma elektrike dhe nga rreziqe të tjera;

- të përshkruajë dhe të zbatojë rregullat e ruajtjes dhe përdorimit të materialeve dhe mjeteve të punës në shërbimet e manikyr pedikyrit;
- të tregojë përdorimin e kutisë së ndihmës së shpejtë dhe mënyrën e dhënies së ndihmës së parë për të dëmtuarit.
- të përshkruajë dhe të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit në repartin e manikyr pedikyrit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Kursanti përshkruan anatominë dhe fiziologjinë e lëkurës, dhe thoit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë ndërtimin e përgjithshëm të duarve dhe këmbëve të njeriut;
- të përshkruajë veçoritë e llojeve të ndryshme të lëkurës së njeriut;
- të përshkruajë ndërtimin dhe fiziologjinë e lëkurës;
- të përshkruajë veçoritë e llojeve të ndryshme të muskulaturës së duarve dhe këmbëve të njeriut;
- të përshkruajë ndërtimin kockor të duarve e kembeve të njeriut.
- të përshkruajë ndërtimin dhe fiziologjinë e muskulaturës së duarve e kembeve të njeriut;
- të përshkruajë ndikimin e anatomisë dhe fiziologjisë së lëkurës, muskulaturës e kockës në aspektet estetike të njeriut.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Pyetje përgjigje me shkrim.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës e qendrës së manikyr pedikyrit. Rekomandohen dhe vizita në biznese që ofrojnë shërbime të manikyr pedikyrit.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në qendër manikyr pedikyri. Atyre duhet t'u jepen detyra të përshkruajnë veçoritë e punonjësit të shërbimeve të manikyr pedikyrit, me funksionet, detyrat dhe veprimtaritë ku mbështetet puna e këtij punonjësi. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e

kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
- Mjedise reale të punës në qendër manikyr pedikyri.
- Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në qendër manikyr pedikyri.
- Tavolina, karrel manikyr pedikyri.
- Legen hidromasazhi për këmbët,
- Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

2. Moduli “Trajtimi dhe masazhimi i duarve”

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	TRAJTIMI DHE MASAZHIMI I DUARVE.	MK-32-231-22
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë dhe procedurat e trajtimit e masazhimit të duarve, si dhe i aftëson ata që të kryejnë trajtime dhe masazhime të ndryshme të duarve.	
Kohëzgjatja e modulit	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulin “Hyrje në shërbimet e manikyr pedikyr”.	
Rezultatet e të Nxënës (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përshkruan veçoritë e trajtimeve dhe masazhimeve të duarve. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të tregojë qëllimin dhe rëndësinë e trajtimeve dhe masazhimeve të duarve; - të përshkruajë llojet e trajtimeve të duarve me parafine dhe masazhet përkatëse; - të përshkruajë procedurat për trajtimin e duarve dhe masazhimin përkatës; - të tregojë veglat, pajisjet dhe materialet për trajtimin dhe masazhimin perkates; - të tregojë përdorimet e produkteve të ndryshme që përdoren për trajtimin dhe masazhimin e duarve. - të organizojë grafikun e takimeve dhe bazën e të dhënave të klientëve; - të përshkruajë rregullat e komunikimit, të higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë trajtimit dhe masazhimit të duarve. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje përgjigje me gojë. - Pyetje përgjigje me shkrim. RN 2 Kursanti trajton duart. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : - të përgatisë klientin për trajtimin dhe duarve; - të marrë informacion paraprak nga klienti; - të analizojë llojin e gjendjes së lëkurës, si dhe muskulaturës së duarve të klientit; - të përzgjedhë veglat dhe mjetet për trajtimin dhe masazhimin e duarve; - të përzgjedhë produktet e duhura në varësi të lëkurës e	

- thoit;
- të përzgjedhë procedurat e duhura për trajtimin e lëkurës së duarve dhe masazhimin përkatës;
 - të zbatojë kërkesat e higjienës personale, të klientëve dhe të mjeteve të punës;
 - të realizojë trajtimin e duarve në legenin e manikyrit;
 - të realizojë trajtimin e zbutjes së thonjve në ujë;
 - të realizojë shtytjen e kutikulave me shtytës;
 - të realizojë pastrimin e kutikulave me pinceta;
 - të lyejë thoin me antimyk (prajmer);
 - të realizojë lyerjen e thoit me bazë manikyri;
 - të realizojë lyerjen e thoit me ngjyrë (kolor);
 - të realizojë lyerjen e thoit me shkelqyes (finish);
 - të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe materialet e punës;
 - të kryejë llogaritjet ekonomike dhe plotësimin e dokumentacionit financiar për shërbimin e kryer;
 - të kryejë regjistrimet në bankën e të dhënave të klientit;
 - të këshillojë klientin për kujdesin e mëtejshëm;
 - të komunikojë me etikë profesionale;
 - të zbatojë rregullat e sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit në punë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje përgjigje me gojë.

RN 3 Kursanti kryen masazhin relaksues të duarve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përzgjedhë mjetet për masazhimin e duarve;
- të përshkruajë procedurën e masazhimit të duarve;
- të realizojë masazhin e duarve me kremra të posaçëm;
- të realizojë masazhin e duarve me parafinë;
- të realizojë trajtimin e duarve me vajra aromatizues;
- të mirëmbajë mjetet dhe materialet e punës gjatë përdorimit të tyre;
- të kryejë llogaritjet ekonomike dhe plotësimin e dokumentacionit financiar për shërbimin e kryer;
- të komunikojë me etikë profesionale me klientin;
- të zbatojë rregullat e sigurisë, higjienës dhe ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje përgjigje me gojë.

RN 4 Kursanti këshillon klientin për mirëmbajtjen e duarve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë problematikat e lëkurës së duarve;
- të këshillojë rreth mënyrës së mirëmbajtjes së duarve;
- të japë informacione për llojet e kremrave që duhet të

- përdorë;
- të informojë klientin për përfitimin e marrë nga trajtimi i duarve;
- t'i rekomandojë klientit vizitë tek dermatologu në rastet e nevojshme;
- të marrë informacione rreth gjendjes shëndetësore të klientit;
- të mirëmbajë mjetet dhe materialet e punës, gjatë përdorimit të tyre;
- të komunikojë me etikë profesionale;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje përgjigje me gojë.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës e qendrës së manikyr pedikyrit. Rekomandohen dhe vizita në biznese që ofrojnë shërbime të manikyr pedikyrit.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës trajton moduli. Rekomandohet të përdoren metodat e lojës me role dhe e simulimit.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në qendër manikyr pedikyri. Atyre duhet t'u jepen detyra për trajtimin dhe masazhimin e duarve me teknika të ndryshme, Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënës.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedisë reale të punës në qendër estetike.
 - Kompleti i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve për të kryer trajtimin dhe masazhimin e duarve, në qendër e manikyr pedikyrit.
 - Produkte për trajtimin e duarve.
Karrel manikyri, legen manikyri, freza, lima, pinceta.
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

3. Moduli “Nërtimi i thoit me manikyr xhel, xhel dhe akrilik”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	NDËRTIMI I THOIT ME MANIKYR XHEL, XHEL DHE AKRILIK,	MK-32-232-22
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë dhe procedurat e realizimit të manikyrës xhel, xhelit dhe akrilikut, si dhe i aftëson ata të kryejnë me cilësi këto shërbime.	
Kohëzgjatja e modulit	110 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç, të kenë kryer modulën “Hyrje në shërbimet e manikyr pedikyrës” dhe “Trajtimi dhe masazhi i duarve”.	
Rezultatet e të Nxënës (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përshkruan veçoritë e ndërtimeve të thoit me manikyr xhel, xhel dhe akrilik. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë veglat dhe pajisjet për kryerjen, sipas rastit të aplikimit të manikyrës xhel, xhelit dhe akrilikut. - të përshkruajë përgatitjen e dorës për kryerjen e masazhimit; - të tregojë rëndësinë e marrjes së informacionit paraprak nga klienti; - të përshkruajë si analizohet lloji dhe gjendja e lëkurës së dorës - të përshkruajë procesin e shtypjes së kutikulave; - të përshkruajë procesin e masazhimit të dorës; - të përshkruajë si trajtohet myku i thonjve; - të përshkruajë procesin e këshillimit të klientit për kujdesin e mëtejshëm; - të përshkruajë përdorimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve dhe materialeve të punës; Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje përgjigje me gojë. - Pyetje përgjigje me shkrim.	
	RN 2 Kursanti ndërton thoin me manikyr xhel. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : - të përzgjedhë mjetet dhe materialet e punës për realizimin e manikyrës xhel; - të përgatitë vendin e punës; - të parapërgatitë thoin për procesin e manikyrës xhel; - të shtyjë dhe të pastrojë kutikulat;	

- të presë kutikulat, nëse është e nevojshme;
- të japë formën e thoit sipas kërkesave të klientit;
- të lyejë thoin me manikyr xhelin;
- të pjekë thoin me manikyr xhel, duke respektuar kohën e tharjes në furrë UV/LED;
- të kryejë masazh relaksues të duarve me produktet përkatëse;
- të këshillojë klientin për kujdesin e mëtejshëm;
- të mirëmbajë mjetet dhe materialet e punës gjatë përdorimit të tyre;
- të kryejë llogaritjet ekonomike dhe plotësimin e dokumentit financiar për shërbimin e kryer;
- të komunikojë me etikë profesionale me klientin;
- të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti ndërton thoin me xhel.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përzgjedhë mjetet dhe materialet e punës për ndërtimin e thoit me xhel;
- të përgatitë vendin e punës;
- të parapërgatitë thoin për procesin e ndërtimit me xhel;
- të shtyjë dhe të pastrojë (presë) kutikulat;
- të japë formën e thoit sipas kërkesave të klientit;
- të aplikojë antimykun (primer-in);
- të aplikojë bazën manikyr në thua;
- të pjekë thoin me bazën e aplikuar, duke respektuar kohën e tharjes në furrë UV/LED;
- të aplikojë xhelin ngjyrues në thua, sipas ngjyrës së kërkuar nga klienti;
- të pjeke thoin me xhel ngjyrues, duke respektuar kohën e tharjes në furrë UV/LED;
- të aplikojë dekorues në thua, sipas dëshirës së klientit;
- të limojë formën përfundimtare të thoit;
- të aplikojë shkëlqyesin në thoin me xhel;
- të pjekë thoin e përfunduar, duke respektuar kohën e tharjes në furrë UV/LED;
- të kryejë masazh relaksues me produktet përkatëse;
- të këshillojë klientin për kujdesin e mëtejshëm;
- të mirëmbajë mjetet e materialet e punës gjatë dhe pas përdorimit të tyre;
- të kryejë llogaritjet ekonomike dhe plotësimin e dokumentit financiar për shërbimin e kryer;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e sigurisë, higjienës dhe ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Kursanti ndërton thoin me akrilil.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë mjetet dhe materialet e punës për ndërtimin e thoit me akrilik;
- të përgatitë vendin e punës;
- të shkëmbejë informacion me klientin për shërbimin që do t'i ofrohet;
- të parapërgatitë thoin për procesin e akrilikut;
- të shtyjë dhe të pastrojë kutikulat;
- të presë kutikulat nëse është e nevojshme;
- të japë formën e thoit sipas kërkesave të klientit;
- të aplikojë antimykun (primer-in);
- të përgatisë në raportet e duhura akrilikun me ngjyrën e kërkuar nga klienti;
- të aplikojë akrilikun në thua;
- të aplikojë dekore të ndryshme, sipas kërkesave të klientit;
- të limojë formën përfundimtare të thoit;
- të aplikojë shkelqyesin mbi akrilik;
- të kryejë masazh relaksues me produktet përkatëse;
- të këshillojë klientin për kujdesin e mëtejshëm;
- të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe materialet e punës;
- të kryejë llogaritjet ekonomike dhe plotësimin e dokumentit financiar për shërbimin e kryer;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e sigurisë, higjienës dhe ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës të repartit të estetikës. Rekomandohen vizita dhe praktika në bizneset ku ofrohen shërbime të manikyr pedikyrir.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në qendrën ku ofrohen shërbimet e manikyr pedikyrir. Atyre duhet t'u jepen detyra praktike, që kanë të bëjnë më procesin e manikyrir xhel, xhelit dhe akrilikut, fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur. Rekomandohet të përdoret simulimi apo lojë me role. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e

	punës që vëzhgojnë. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedise reale të punës, ku ofrohen shërbimet manikyr pedikyr. - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve për aplikimin e manikyr të thjeshtë, manikyr të xhel dhe akrilikut. - Tavolina , karrel manikyr pedikyr. - Produkte për aplikimin e manikyr të xhel, xhelit dhe akrilikut. - Dorë manekini. - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

4. Moduli “Trajtimi estetik i këmbëve”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	TRAJTIMI ESTETIK I KËMBËVE	MK-32-233-20
Qëllimi i modulit	Nje modul që e njeh kursantin me veçoritë dhe procedurat e trajtimit estetik të këmbëve dhe i aftëson ata të kryejnë procedurën e pedikyrit, masazhimit relaksues të këmbëve dhe këshillimit të klientit për mirëmbajtjen e këmbëve.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulin “Hyrje në shërbimet e manikyr pedikyrit”.	
Rezultatet e të Nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përshkruan anatomicin dhe fiziologjinë e lëkurës së këmbëve, si dhe sëmundjet e thoit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë ndërtimin anatomik të këmbës; - të përshkruajë veçoritë e llojeve të ndryshme të lëkurës së këmbëve; - të dallojë sëmundjet e ndryshme të thonjeve të këmbës; - të përshkruajë sëmundjet e ndryshme të thonjeve të këmbës; - të argumentojë rëndësinë e trajtimit të këmbëve; - të për zgjedhë saktë produktet që përdoren në trajtimin e këmbëve; - të tregojë përdorimet e duhura të produkteve që përdoren në trajtimin e këmbëve. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje përgjigje me gojë. - Pyetje përgjigje me shkrim.	
	RN 2 Kursanti kryen procedurën e pedikyrit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë procedurën e pedikyrit; - të përshkruajë mjetet dhe materialet e nevojshme të punës për të kryer procedurën e pedikyrit; - të për zgjedhë mjetet dhe materialet e punës për procedurën e pedikyrit; - të përgatisë klientin për kryerjen e procesit të pedikyrit; - të hidhen kripëra esenciale në vaskën masazhuese të këmbëve; - të vendosë këmbët e klientit në vaskën masazhuese të këmbëve, për zbutjen e tyre. - të respektojë kohën e duhur për mbajtjen e këmbëve në	

- vaskën masazhuese;
- të thajë mirë këmbët pas qëndrimit në vaskën masazhuese;
- të pastrojë kallot me brisk;
- të limojë thëmbërat e këmbëve me limat përkatëse;
- të masazhojë këmbët;
- të aplikojë parafinën për këmbët;
- t'u japë formë thonjve të këmbëve;
- të pastrojë kutikulat e thonjve të këmbëve;
- të aplikojë antimykun;
- të aplikojë manikyr xhelin/ xhelin/ akrilikun sipas kërkesës së klientit;
- të realizojë ose jo pjekjen sipas rastit;
- të aplikojë shkëlqyesin në thonjtë e këmbëve;
- të masazhojë këmbët me kremra ose vajra sipas kërkesës së klientit;
- të këshillojë klientin për kujdesin e mëtejshëm të këmbëve;
- të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe materialet e punës;
- të kryejë llogaritjet ekonomike dhe plotësimin e dokumentit financiar për shërbimin e kryer;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e sigurisë, higjienës dhe ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti kryen masazhin relaksues të këmbëve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë procedurën e masazhimit relaksues të këmbëve;
- të përshkruajë mjetet dhe materialet e nevojshme të punës për të kryer masazhimin relaksues të këmbëve;
- të përgatisë klientin për masazhimin relaksues të këmbëve;
- të përzgjedhë mjetet dhe materialet e nevojshme të punës për të kryer masazhimin relaksues të këmbëve;
- të aplikojë parafinën për këmbët;
- të realizojë masazhin e këmbëve me kremra të posaçëm
- të realizojë trajtimin e këmbëve me vajra aromatizues;
- të mirëmbajë mjetet dhe materialet e punës gjatë gjatë përdorimit të tyre;
- të kryejë llogaritjet ekonomike dhe plotësimin e dokumentacionit financiar për shërbimin e kryer;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e sigurisë, higjienës dhe ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Kursanti këshillon klientin për mirëmbajtjen e këmbëve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të marrë informacione rreth gjendjes shëndetësore të klientit;
- të këshillojë klientin për mënyrat e mirëmbajtjes së këmbëve;
- të japë informacione për llojin e trajtimit të këmbëve që duhet të marrë klienti;
- të informojë klientin për përfitimin e marrë nga trajtimi i duhur i këmbëve;
- t'i rekomandojë klientit vizitë tek dermatologu në rastet e nevojshme;
- të komunikojë me etikë profesionale
- të zbatojë rregullat e sigurisë, higjienës dhe ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së qendrës së estetikës që ofrojnë shërbime pedikyri. Rekomandohen vizita në biznese që ofrojnë shërbime pedikyri
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës ku ofrohen shërbimet pedikyr. Atyre duhet t'u jepen detyra të përshkruajnë trajtimin estetik të këmbëve, si dhe veprimtaritë ku mbështetet puna e tyre. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënës.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedisë reale të punës në qendër estetike.
 - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në qendër estetike.
 - Legen pedikyri.
 - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

5. Moduli “Zgjatimi dhe riparimi i thonjve”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	ZGJATIMI DHE RIPARIMI I THONJVE	MK-32-234-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me procesin dhe teknikat e zgjatjes dhe riparimit të thonjve, si dhe i aftëson ata për kryerjen e zgjatimit të thonjve me tips dhe kartinë, dhe për punim akriliku e ngjitjen e thoit me fibër/copë/mëndafsh.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç, të kenë kryer modulën “Hyrje në shërbimet e manikyr pedikyrë” dhe “Trajtimi dhe masazhi i duarve”.	
Rezultatet e të Nxënës (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti realizon zgjatimin e thoit me tipsa. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përzgjedh mjetet dhe materialet e punës për zgjatimin e thonjve; - të përgatisë vendin e punës; - të përgatisë mjetet e domosdoshme për zgjatimin e thoit; - të përzgjedhë llojin dhe numrin e përshtatshëm të tipsit; - të pastrojë kutikulat; - të përgatisë thoin për ngjitjen e tipsit; - të realizojë ngjitjen e tipsit; - të aplikojë antimykun mbi thoin e zgjatur; - të aplikojë bazën e xhelit; - të ndërtojë thoin me xhel; - të aplikojë ngjyruetin, sipas kërkesës së klientit; - të aplikojë shkëlqyesin; - të realizojë masazhin; - të këshillojë klientin për mirëmbajtjen e mëtejshme të thonjve; - të plotësojë dokumentin financiar për shërbimin e kryer; - të kryejë regjistrimin në bankën e të dhënave të klientit; - të komunikojë me etikë profesionale; - të zbatojë rregulat e sigurisë, higjienës dhe ruajtjes së mjedisit. - të kryejë llogaritjet ekonomike dhe plotësimin e dokumentit financiar për shërbimin e kryer. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli.	
	RN 2 Kursanti kryen zgjatimin e thoit me kartinë. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë :	

- të përzgjedhë mjetet e materialet e punës për zgjatimin e thonjve me kartinë;
- të përgatisë mjetet dhe vendin e punës;
- të parapërgatisë thoin për vendosjen e kartinës zgjatuese;
- të pastrojë kutikulat
- të vendosë kartinën zgjatuese mbi thua, sipas procedurës;
- të aplikojë antimykun mbi thua;
- të aplikojë bazën e thoit, sipas procedurës;
- të aplikojë zgjatimin e thoit mbi kartinë;
- të ndërtojë thoin, duke e limuar, sipas formës së kërkuar;
- të heqë kartinën e tepërt nga thoi;
- t'i japi formën përfundimtare thoit;
- të aplikojë ngjyresin mbi thoin e zgjatur, sipas kërkesës së klientit;
- të aplikojë shkëlqyesin mbi thoin e zgjatur;
- të kryejë masazhin me produktet përkatese;
- të këshillojë klientin për kujdesin e metejshëm;
- të mirëmbajë materialet e punës gjatë përdorimit të tyre;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të kryejë regjistrimin në bankën e të dhënave të klientit;
- të zbatojë rregullat e sigurisë, higjienës e ruajtjes së mjedisit;
- të kryejë llogaritjet ekonomike dhe plotësimin e dokumentit për shërbimin e kryer.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti ngjit thoin me fibrë/copë/mëndafsh, për riparimin e tij.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përzgjedhë mjetet dhe materialet e punës;
- të përgatisë vendin e punës;
- të prezantohet me thoin e dëmtuar të klientit;
- të përzgjedhë sipas nevojës fibrën/copën/mëndafshin, për riparimin e thoit;
- të kryejë ngjitjen e materialit të përzgjedhur me thoin e dëmtuar;
- të sistemojë thoin e ngjitur, duke i dhënë formën e duhur;
- të aplikojë antimykun mbi thoin e riparuar, nëse është e nevojshme;
- të mbushë thoin e riparuar me manikyr xhelin/xhelin/ akrilikun, sipas llojit të mbushjes së mëparshme;
- të aplikojë ose jo dekorin mbi thoin e riparuar sipas kërkesës;
- të aplikojë shkëlqyesin mbi thoin e riparuar;
- të pjekë thoin e riparuar;
- të këshillojë klientin për kujdesin e metejshëm të thonjve;
- të komunikojë me etikë profesionale;

- të kryejë regjistrimin e të dhënave në bankën e klientit
- të zbatojë rregullat e sigurisë, higjienës dhe ruajtjes së mjedisit;
- të kryejë llogaritjet ekonomike dhe plotësimin e dokumentit financiar për shërbimin e kryer.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së qendrës së estetikës. Rekomandohen dhe vizita në biznese që kryejnë veprimtari të zgjatimit dhe riparimit të thonjve.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në qendër estetike. Atyre duhet ti jepen detyra të përshkruajnë veçoritë e zgjatimit të thoit me tipsa dhe letër, si dhe ngjitjen e thoit me fibër, copë dhe mëndafsh për riparimin e tyre. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedisë reale të punës në qendër estetike.
 - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në qendër estetike.
 - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-